

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët, Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Shqipe Qerimi e Hashim Çollaku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Besnike Miftari, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B. nga fshati ..., komuna e Drenasit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) dhe veprës penale kanosje nga neni 185 par.3 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit A.R., av. V.H., të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1457/2018 të datës 10.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.08.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit A.R., av. V.H., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.1457/2018 të datës 10.04.2018, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, P.nr.1457/2018 të datës 10.04.2018, të akuzuarin A.B. e ka shpallur fajtor për shkak se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 nënpar.1.4 të KPRK dhe veprën penale kanosje nga neni 185 par.3 të KPRK, dhe për secilën vepër veç e veç gjykata i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej nga 400 € (katërqind). Bazuar në nenin 80 të KPRK, gjykata të akuzuarit i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në shumë prej 800 € (tetëqind), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti gjatë periudhës verifikuese prej një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër të re penale. I akuzuari është obliguar që të paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të bëhen sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, dhe atë shumën prej 20,00 në emër të ekspertizës mjeko-ligjore, shumën prej 30€ për programin për kompensimin e viktimave të krimit si dhe në emër të paushallit gjyqësor, shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyimit, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim. I dëmtuari A.R. nga Fushë Kosova, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi më parë në afatin ligjor ankesë kishin paraqitur Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovojë ankesën si të bazuar, të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptojë dënim me burg efektiv dhe mbrojtësja e të akuzuarit A.B., av.A.Z. për shkak të vendimit mbi dënimin dhe vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë të aprovojë ankesën si të bazuar, të ndryshojë aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptojë dënim me gjobë të kushtëzuar më të ultë si dhe të njëjtin ta lirojë nga obligimi i shpenzimeve të procedurës penale. Kjo gjykatë me aktgjykimin PA1.nr.518/2018 të

datës 25.05.2018, kishte refuzuar si të pa bazuara ankesat e lart cekura. Bazuar në shkresat e lëndës, i dëmtuari në rastin konkret, A.R., aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, P.nr.1457/2018 të datës 10.04.2018 e ka pranuar me datë 04.06.2018 dhe duke e shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore, përfaqësuesi i tij, av. V.H., me datë 11.06.2018 ka parashtruar ankesë kundër aktgjyimit të gjykatës së shkallës së parë vetëm për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që ankesa e tij, të aprovohet, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të akuzuarit A.B. ti shqiptohet sanksion më i ashpër penal, dënim me burg të kushtëzuar.

Prokurori i Apelit, me shkresën PPA/II.nr.656/2018 datë 28.06.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, av. V.H. të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i ashpër.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

- Ankesa është e pabazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi në këtë aspekt komfor dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase me ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 06.04.2018 e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjyimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit, av. V.H. me ankesë pretendon se përkundër faktit se i akuzuari ka pranuar fajësinë, se është penduar për kryerjen e veprës penale, se më parë nuk ka qenë i dënuar, gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë që dënimin të jetë adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Sipas ankesës, ndaj të akuzuarit është shqiptuar dënim i butë sepse nuk është marrë si rrethanë rënduese që të dëmtuarit lëndimi i është shkaktuar në zyre ku edhe është kanosur, nuk është vlerësuar vendosmëria e të akuzuarit për kryerjen e veprave penale dhe paramendimi i tij dhe po qe se gjykata do ti vlerësonte rrezikshmërinë shoqërore, përgjegjësinë penale dhe rrethanat tjera, atëherë me siguri të akuzuarit do ti shqiptonte një dënim më adekuat.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me vendimin mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit, av. V.H. për dënim më të ashpër, nuk janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimin në mënyrë të plotë dhe gjithë përfshirëse i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat në pajtim me nenin 73 dhe 74 të KPPK-së, me ç' rast si rrethana lehtësuese në anën e të akuzuarit ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin e sinqertë, se më parë nuk ka qenë i dënuar si dhe

premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale, faktin se i akuzuari është prind i gjashtë fëmijëve, i pa punë e me gjendje të varfër ekonomike ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Kjo gjykatë, vlerësimin e rrethanave relevante të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë e pranon si të drejtë dhe të bazuar në ligj, prandaj duke pas parasysh të gjitha rrethanat që i ka konstatuar dhe drejtë i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë, duke aplikuar dispozitën e nenit 73 e 74 të KPPK, duke vlerësuar faktin se në ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit nuk ceket asnjë rrethanë që nuk është vlerësuar më parë nga gjykata e shkallës së parë, e që sipas vlerësimit të kësaj gjykate do të ndikonte që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë, ndërsa rrethanat e pretenduara rënduese në ankesë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate kanë qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë,

Pra, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjykimit nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprave të kryera penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe se ky dënim duhet t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar, kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.649/18 me datë 08.08.2018

Bashkëpunëtorja profesionale
Besnike Miftari

Kryetari i kolegjit-gjyqtari
1. Gani Zabeli

Anëtarët e kolegjit:

2. Shqipe Qerimi
3. Hashim Çollaku